



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:209904
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05631403

PA1.nr.1509/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.M nga fshati, Komuna e Drenasit, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1. nënpar.1.4.të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, P.nr.297/23 të dt.19.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit G.M , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, P.nr.297/23 të dt.19.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, me aktgjykimin, P.nr.297/23 të dt.19.10.2023, të akuzuarit G.M , për shkak veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1. nënpar.1.4.të KPRK-së , e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin detyrohet t'a paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi. Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim. Kur dënim me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së. Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në

tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) € gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë. Detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 (njëzetë) euro, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë. E dëmtuara N.G, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, nuk ka ushtruar kërkesë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

I akuzuarit G.M, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjukata e Apelit e Kosovës këtë ankesë ta aprovoj, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të ulët.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1543/23 të datës 29.11.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit G.M , ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjukata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjukata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

I akuzuari, G.M e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se i njëjti është tepër i lartë duke pas parasysh individualizimin e dënimit dhe se aspak nuk mishëron qëllimet e parapara me nenin 38 të KPRK-së. Pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka trajtuar me kujdes individualizimin e dënimit dhe përcaktimin e një dënimi sa më të drejt të mundshëm që do ti vinte në jetë qëllimet e dënimit e duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për përcaktim të dënimit, e këtë

e sheh nga fakti se sa sipërfaqësisht janë trajtuar ato në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar. Tutje konsideron se meqë i akuzuari nuk qëndron mire me shëndet dhe terapia e tij ka kosto të lartë, caktimi i dënimit e gjobë në vlerë prej 500 (pesëqind) euro për të akuzuarin është tejet i lartë dhe i pa përballueshëm duke rrezikuar kështu edhe ekzistencën e tij dhe të familjes.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të akuzuarit, që ti shqiptohet dënim më i ulët, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me të ulët për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku për të pandehurin si rrethanë lehtësuese merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, nuk ka të dhëna se ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, gjykatës i premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohet shumë për veprën e kryer penale, kërkon falje, e pranoi se ka gabuar, shpreh keqardhje dhe gjendjen e tij të dobësuar shëndetësore, ashtu siç u përshkrua më lartë, ndërsa rrethana rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjes nga i akuzuari gjatë kryerjes së kësaj vepre penale. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të ulët. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitivin e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1509/23, më datë 22.04.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Zyhdi Haziri